

AZILI në Hungari

Një udhëzues për të huajt që kanë nevojë për mbrojtje

- Si të aplikojmë për azil?
- Çfare ndodh gjate procedurës për strehim?
- Çfare statusi ke të drejte te kërkosh në rast s e keni nevojë për mbrojtje në Hungari?
- Ku mundeni të kërkoni ndihmë?



1. Faktet baze

Ju për momentin ndodheni në Republikën e Hungarisë (*Magyarország*) – Popullata: 10 milion, gjuha zyrtare: Hungareze (*magyar*). Hungaria është shtet anëtar i Bashkimit Evropian (EU), dhe ndodhet në Evropën qendrore. Për detaje të mëtejshme keni një hartë të shtetit në fund të këtij dokumenti.

Çdo i huaj ka të drejtë të aplikojë për strehim në këtë shtet, në bazë të ligjeve Hungareze dhe Internacionale. Në rast se ju jeni i rrezikuar nga persekutimi, tortura ose të drejtat e juaja njerëzore janë dhenuar në vendin tuaj të lindjes atëherë, autoritetet Hungareze nuk mund t'ju dërgojnë mbrapa në vendin tuaj.

Ky dokument përmban informacione bazë për t'ju dhëne juve ndihmën e duhur gjatë procedurës për strehim. Në qofte se keni nevojë për me shume këshilla ose nuk kuptoni ndonjëgjë, ju mund te kërkonti ndihmën e një avokati ose të një punonjësit social të cilin jua përcaktojnë falas (për me shume kontakti informacionin në faqet 13, 15).

Disa fjale te rëndësishme për ju do te përmenden në gjuhën Hungareze (*me të pjerrëta*). Në fund të çdo seksioni të këtij dokumenti ndodhet një pjesë Pyetje dhe Përgjigje, kjo shërben për t'ju ndihmuar juve për t'ju përgjigjur disa pyetjeve tipike që përsëriten shpesh gjatë procedurës se azilit.

2. Kush ka te drejtën e mbrojtjes në Hungari?

Në rast se situata juaj është e ngjashme me njëra nga situatat e mëposhtme atëherë ju do te keni të drejtën t'ju japin mbrojtje dhe ju mund te qëndroni ligjërisht në Hungari:

- **Emigranti (*menekült*):** Ai person i cili ka një frikë te themeluar me baza te shëndosha qe është i persekutuar në vendin e tij të lindjes për shkak te racës, besimit, kombësisë, qëndrimit politik ose për shkak se është pjesëtar i “një grupi te veçante”.
 - “Persekutim” në këtë rast do të thotë dhunimi i te drejtave te njeriut, si për shembull torturat, trajtimet jo-njerëzore ose degraduese, skllavëria, dhuna fizike ose seksuale ose diskriminimi në mase.
 - Në rast se ju keni probleme ose ju nuk keni mbrojtjen e duhur nga shteti juaj për shkak se ju jeni grua, homoseksual ose për shkak se ju keni ndonjë karakteristike tjetër të veçante, të cilën ju nuk mund ta ndryshoni dot (ose ju nuk keni dëshirë ta mbani të fshehte atë), ju në këtë rast i përkisni “grupit te veçante social”. në lidhje me këtë çeshtje avokati juaj mund t'ju japë juve informacione të mëtejshme.
- **Statuti Person i mbrojtur (*oltalmazott*):** Një person të cilit jeta e tij/saj është në rrezik të vërtete në vendin e tij/saj të lindjes, për arsye se cenohet prej njërës nga më poshtë, por JO për shkak te racës, besimit, kombësisë, opinionit të tij politik, ose për arsye se është pjesëtar i ndonjë grupi “social të veçante politik”.
 - Dënimi me vdekje.
 - Tortura, keqtrajtimi jo njerëzor ose degradues.
 - Kërcënimi serioz i jetës se një civil i ose një personi për shkak të dhunës qe nuk bën dallim në një konflikt të armatosur (për shembull në rast se në vendin tuaj te lindjes ka një luftë civile).

- **Statuti Person i toleruar (*befogadott*):** Një person që ka frikë nga persekutimi, tortura, trajtimi jo njerëzor ose degradues ose kërcënohet nga dënimi me vdekje por nuk mund të përfitojë statusin e refugjatit ose nuk mund të jete person i mbrojtur (për shembull, për arsye se ka bere një krim të rëndë).
- **Statuti Pa kombësi (*hontalan*):** Një person i cili nuk ka një kombësi. Kjo çështje shqyrtohet veçantë dhe JO në procedurën e azilit. në rast se ju doni te aplikoni për këtë status, atëherë ju duhet ti drejtoheni Organizatës të Helsinkit në Hungari (kontaktoni informacionin në faqet 13, 15).

? **Në rast se unë nuk jam i kërcënuar nga shteti, por nga një grup tjetër shoqëror, ose person (për shembull nga familja ime, ose nga një grup politik, ose nga një organizate terroriste, etj). A ka ndonjë ndryshim?**

Jo, edhe në këtë rast ju mund të jeni akoma një refugjat, nuk ka nevojë të jeni i persekutuar nga shteti.

? **A mund të marr mbrojtje në Hungari në rast se unë e kam lënë vendin tim për shkak se isha i varfër dhe nuk kisha mundësi të gjeja punë?**

Jo, në qoftë se s'ka ndonjë arsye tjetër më specifike. Kushtet e këqija ekonomike, financiare ose te ambientit në vendin tuaj të lindjes nuk ju japin të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare.

3. Ku dhe si mund te kërkoj azil?

- **Sa me shpejt të jetë e mundur,** ju duhet të kontaktoni **Zyrën e Nenshtetesise dhe te Emigracionit** (*Bevándorlási és Állampolgársági Hivatal, BÁH*) – e njohur dhe si “Zyra e Emigracionit” – dhe të kërkonit azil, në rast se keni frikë se mund t’ju dhunohen të drejtat e juaja në rast se ju ktheheni në vendin e lindjes. Ju mund te kontaktoni Zyrën e Emigracionit për shembull në adresat e mëposhtme:
 - **Zyra e nenshtetesise dhe Emigracionit, Drejtoria e Punëve te Refugjateve**
Adresa: 1117 Budapest, Budafoki út 60.
Tel: 06 1 463 9170 • Fax: 06 1 463 9108
Internet: www.bm-bah.hu • E-mail: menekult@bah.b-m.hu
 - **Békéscsaba kampi refugjateve**
Adresa: 5601 Békéscsaba, Kétegyházi út 10.
Tel: 06 66 452 507, 06 66 452 617 • Fax: 06 66 445 462
 - **Debrecen kampi refugjateve**
Adresa: 4033 Debrecen, Sámsoni út 149.
Tel/fax: 06 52 413 517

Në rast se për momentin ju ndodheni në burg, ose në një proces përjashtimi, ose për ndonjë arsye tjetër ju nuk mund te shkoni në Zyrën e Emigracionit atëherë ju mund të bëni kërkes për azil edhe në **Polici** (*Rendőrség*).

- **Ne çfarë mënyre:** Për këtë nuk ka rregulla të veçanta ju mund të kerkoni nga Zyra e Emigracionit azil me shkrim ose me goje **në çfarëdo lloj gjuhe**. Është e rëndësishme që ju t’ia bëni të ditur personit që po kërkonit azil këtë gjë në një gjuhe te kuptueshme për atë. Zakonisht po e kërkoje me goje azilin më vonë do ta kërkojnë me shkrim. Kini kujdes se në Hungari në përgjithësi policet nuk flasin asnjë gjuhe te huaj!

Ne rast se ke frike se polici nuk do ta kuptoje se ti po kërkon azil atëhere thuaj fjalën “MENEKÜLT” (refugjat) ose “MENEDÉK” (azil) në Hungarisht dhe shkruaje në letër në gjuhen tënde të nënës kërkesën për azil. Dhe duhet ta nënshkruash me emrin tënd ti vete.

? A mund te jap kerkesen per azil në qoftese une kam ardhë në menyre joligjore në Hungari?

Po. Shumë refugjatë nuk kanë mundësi tjetër për të kërkuar ndihme dhe mbrojtje dhe në këtë rast janë të detyruar të shkojnë në mënyre joligjore në një vend (me dokumente false ose pa pasaporte dhe vize). Pamvarsisht se ti ke ardhë në mënyre joligjore, në rast se Zyra e Emigracionit e pranon kërkesën tënde për azil ose ti je një person i mbrojtur atëherë ti ke të drejte të qendrosh ligjërisht në Hungari.

**Ne qofte se ju hyni në Hungari në mënyrë ilegale (me dokumente false ose pa pasaporte dhe vize) dhe dëshironi të kërkonti azil, është shumë e rëndësishme që ju me dëshirën tuaj dhe sa më shpejt të kontaktoni Zyrën e Emigracionit ose Policinë. Ju duhet ti tregoni atyre sa me shpejt që ju keni dokumente false dhe doni të kërkonti azil.
Ne qofte se keni mundësi ju duhet ti tregoni dokumentata e juaja të verteta edhe pse keni hyre në Hungari me dokumente false.**

? A mund te kërkoj azil në qofte se unë jam i dënuar (ne burg)?

Po. në këtë rast ju mund ta jepni kërkesën tuaj për azil rojës së burgut ose Policisë.

? A mund ta refuzoje roja e burgut ose Policia kërkesën time për azil?

Jo. Ata janë të detyruar ta dërgojnë kërkesën tuaj Zyrës së Emigracionit. në rast se ata nuk pranojnë, atëherë menjëherë ju duhet te kontaktoni Këshillin e Helsinkit në Hungari ose Organizatën e Kombeve të Bashkuar për Refugjatet (UNHCR) (kontaktoni personin në faqet 13, 15).

? Sa herë kam të drejt të bëj kërkesë për azil në Hungari?

Ne rast se kërkesën tuaj nuk e kane pranuar një here, në raste te veçanta ju mund te bëni një kërkesë te re. Por duhet te keni parasysh qe:

- Kërkesa juaj e re do te pranohet vetëm në rast se ju keni ndonjë fakt te ri, ose ndonjë informacion të ri që ju nuk e keni thënë në kërkesën e mëparshme (Për shembull në rast se situata në vendin tuaj te lindjes ka ndryshuar ose gjendja juaj personale).
- Ne qofte se ju keni qëndruar në Hungari ilegalisht, dhe ju kanë refuzuar dy herë kërkesën për azil, kërkesa e trete nuk do te jete një pengese për përjashtimin tuaj nga Hungaria.

? A mund te kërkoj azil në aeroport?

Po. në qofte se ju vini në Hungari nëpërmjet aeroportit të Budapestit, atëherë është shumë e rëndësishme që ju të kërkonti azil tek policia e aeroportit sa me shpejt të jetë e mundur. në këtë rast, Policia do të informoj Zyrën e Emigracionit rreth aplikimit tënd për azil, dhe në shumicën e rasteve derisa të marrin një vendim do qëndroni disa dite në një dhomë në aeroport në zonën transit.

? Ne qofte se jam bashkë me familjen duhet ta bëjmë bashkë kërkesën për azil apo veçantë?

Te rriturit (mbi moshën 18 vjeç) mund ta bëjnë kërkesën veçat nga familja, por është më mirë që kërkesën ta bëni bashkë. Fëmijët (nen moshën 18 vjeç) te cilët vijnë bashke me familjen e tyre (prindërit, ose gjyshërit, etj.) nuk mund te aplikojnë veçantë; ata duhet te përfshihen në aplikimin që prindërit e tyre bëjnë për azil.

4. Cilat janë te drejtat e mia gjatë procedurës për azil?

Gjatë gjithë procesit tënd për azil ju keni të drejtë të:

- Të përdorni gjuhën tënde amtare ose ndonjë gjuhë tjetër që ju e flisni mirë (ne rast se keni nevojë për përkthyes do t'ju japin një përkthyes).
- Të keni një përkthyes të të njëjtës gjini si ju (ne rast se është mundur dhe ju dëshironi).
- Të keni një nëpunës azili të të njëjtës gjini si ti (ne rast se keni frike ose probleme me nëpunës të gjinis tjetër ose ju dëshironi kështu).
- Të keni një kopje të të gjitha vendimeve që janë marre në lidhje me ty gjatë procesit të azilit në Hungari.
- T'ju tregojnë përmbajtjen e të gjitha vendimeve gjate procesit të azilit në gjuhën tënde të nënës ose në një gjuhë tjetër që ju e kuptoni mire.
- Të keni asistencën ligjore të një avokati falas ose të një organizate jo-qeveritare (shikoni kontaktin në faqet 13, 15).
- Të kontaktoni zyrën e Këshillit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatet (UNHCR) në Budapest (shiko kontaktin në faqen 15).

Sigurohu që ti dhe përkthyesi/përkthyesja jote e kuptoni mirë njeri-tjetrin.

Ka raste që përkthyesi flet me dialekt tjetër të gjuhës që flisni ju ose flet me një theks tjetër nga ju, dhe ju mund ta mos kuptoni atë.

Gjatë procedurës tënde për azil përkthyesi duhet të qëndroje neutral; përkthyesi nuk ka të drejtë t'ju bëjë juve pyetje, ose t'ju ngatërrojë juve në lidhje me kërkesën për azil. Në rast se ju keni vështirësi komunikimi me përkthyesin, ose mendoni se përkthyesi nuk mban qëndrim neutral, atëherë ju mund të kërkonti ndihmën e përkthyesit ose të avokatit tuaj, dhe të kërkonti një përkthyes tjetër.

Avokati tuaj (përfaqësuesi ligjor) mund t'ju ndihmojë juve gjatë procedurës për azil dhe mund të:

- Jetë prezent, t'ju bëjë pyetje dhe korigjime gjatë gjithë proceseve dhe intervistave tuaja me autoritetet ose në gjykatë.
- Te lexojë dhe të bëjë fotokopjen e të gjitha dokumenteve të përdorura gjatë procedurës për azil.
- T'ju marre në telefon, t'ju shkruaj ose t'ju bëjë juve një vizitë (edhe pse ju jeni i dënuar në burg).

? A kam të drejtë të qëndroj në Hungari në gjatë procesit për azil, edhe pse kam hyre në këtë vend në mënyre ilegale?

Po. Ju mund të përjashtoheni nga Hungaria vetëm në atë rast se të gjithat kërkesat tuaja për azil janë refuzuar nga Zyra e Emigracionit ose nga gjykata mbas apelimit tuaj. Por sidoqoftë kjo është e vlefshme vetëm deri mbas dy procedurave të para për azil. Procedura e tretë nuk do pengojë përjashtimin tuaj nga Hungaria.

? Kam hasur në disa gabime gjatë përkthimi dhe gjatë marrjes në pyetje (përkthyesi e ka përkthyer ndonjë fjalë gabim, nuk kuptova çfarë tha, etj.), por vetëm disa dite/jave mbas intervistës hasa në këto gabime. Çfarë mund të bëj në këtë rast?


Në fund të intervistës kur ju firmosni letrat që përmbajnë intervistën do të thotë që ju e keni kuptuar çfarë ka përkthyer përkthyesi. Kjo do të thotë që është shumë e vështirë të vërtetosh mbas firmosjes që ju nuk jeni kuptuar mirë me përkthyesin. Kështu që bëni kujdes të madh në fund të intervistës kur ju lexohen edhe njëherë ato çfarë keni thënë në interviste. Në rast se keni ndonjë problem mbas leximit atëherë ju duhet ta thoni menjëherë (edhe vërejtjen me te vogël).

5. “Procesi i parapranneshmërisë”

Procesi për azil ka dy faza. Faza e parë është “procesi i paraprannimit”, mbas të cilit vjen një “proces për meritë”.

Kur ju kërkoni azil në Hungari, së pari ju duhet të kaloni një kontroll që quhet “**Procesi paraprannimit**” (*előzetes vizsgálati eljárás*). Në këtë fazë të parë të procedurës për azil, Zyra e Emigracionit nuk ekzaminon akoma çështjen tuaj që juve do t’ju keqtrajtojnë ose te drejtat e juaja njerëzore do te dhunoeshin në rast se do t’ju kthenin në vendin e lindjes.

Figura e mëposhtme do t’ju ndihmojë juve në lidhje me procesin e parapranneshmërisë:



Procesi i parapranneshmërisë në përgjithësi zgjat **15 dite** mbas kërkesës tënde për azil. Në disa raste mund zgjasë edhe më shumë, në rast se afati është zgjatuar (shiko në faqet 7, 9.)

Në rast se ju e bëni aplikimin për azil në aeroport (shiko në faqen 4) Zyra e Emigracionit duhet ta mbylli procesin e parapranneshmërisë brenda **8 ditëve**.

A. “Procedura DUBLINIT”

Në Bashkimin Evropian vetëm një shtet i Bashkimit Evropian duhet të merret me çështjen e një personi që kërkon azil. Ky shtet është shteti i parë i BE-se që ky azilant ka hyrë. Prandaj në procesin e paraprannimit Zyra e Emigracionit do të shqyrtojë se cili shtet duhet të merret me kërkesën tënde për azil. Me fjale të tjera kjo quhet dhe “**Procedura e Dublinit**”.

Kjo procedure zhvillohet vetëm në atë rast, në qoftë se Zyra e Emigracionit mendon se ju me përpara keni udhëtuar ose keni bërë kërkesën për azil në një nga vendet e mëposhtme:

Austri	Finlande	Irlande	Norvegji	Slovaki
Belgjike	France	Itali	Qipro	Sloveni
Bullgari	Gjermani	Letoni	Poloni	Spanje
Britani e Madhe	Greqi	Lituani	Portugali	Suedi
Danimarke	Hollande	Luksemburg	Republika Çeke	Zvicër
Estoni	Islande	Malte	Rumani	


Te keni parasysh që Islanda, Norvegjia dhe Zvicra nuk bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian por ata bëjnë pjesë në “Marrëveshjen e Dublinit”.

Në praktike kjo ndodh kur:

- Autoritetet përkatëse në bazë të shenjave të gishtërinjve (te cilat ruhen në sistemin e te dhënave të Evropës të quajtura “**Eurodac**”), tregon që ju keni bërë kërkesën për azil me herët në një nga vendet e mësipërme,

- Ti ke një vize në pasaportën tënde të një nga këtyre vendeve,
- Dhe në rast se ti i tregon autoriteteve përkatëse se ti ke kaluar kufirin e një nga këtyre vendeve për të hyrë në Hungari,
- Ekzistojnë dhe shenja të tjera: për shembull, kur autoritet gjejnë ndonjë para Suedeze ose ndonjë bilete metroje te Parisit në xhepat tuaja.

Figura e mëposhtme shpjegon se si funksionon procesi i Dublinit në praktike. Rumania është marrë vetëm si shembull.



“Procesi Dublinit” mund të zgjasë për një kohë të gjatë, për muaj ose për jave të tera sepse do kohë derisa të marrim një përgjigje nga një shtet tjetër i Bashkimit Evropian. Prandaj, në rast se Zyra e Emigracionit nis procesin e Dublinit në lidhje me çështjen tënde, **procedura juaj e parapranimit do të pezullohet derisa të merr fund procesi i Dublinit**. Kjo do të thotë që në disa raste procedura e parapranimit mund të zgjasë më shumë se 15- ditë.

Në rast se Zyra e Emigracionit vendos se çështja juaj e aplikimit për azil duhet ti dorëzohet një shteti tjetër të Bashkimit Evropian, dhe ju nuk dëshironi që kjo çështje ti çohet një shteti tjetër atëherë, **ju mund të apelonit kundër këtij vendimi**. Apeli juaj duhet ti paraqitet Zyrës së Emigracionit **brenda 3 ditëve**, në lidhje me apelin tuaj vendos **Gjykata e Kryeqytetit (Fővárosi Bíróság)** në Budapest. Duhet të dini se ka shumë pak gjasa që apeli juaj të pranohet për arsye se:

- Gjykata do vendosi vetëm në bazë të dosjes që kanë rreth jush dhe nuk do ju marrin në interviste përsëri, dhe.
- shkakut se ju apeluati nuk do të pengojë që juve t’ju transferojnë. Me fjalë të tjera kjo do të thotë që Zyra e Emigracionit mund t’ju transferojë juve në qytetin tjetër të Bashkimit Evropian (BE) i cili është përgjegjës për kërkesën tënde për azil, edhe në rast se gjykatësi nuk ka marre akoma

vendim në lidhje me apelimin tënd. Sidoqoftë në rast se ju i kërkonti gjykatës që ta pezulloje transferimin tënd, atëherë gjykatësi mund të vendosi që ta pezulloje atë derisa të marri një vendim. Të keni parasysh që kjo mund të ndodhe shumë rrallë.

Afati zyrtar për këtë vendim është **8 dite**. Në praktike ai mund të zgjas edhe më shumë.

Në lidhje me këtë çështje ju mund të kërkonti një këshillë nga avokati i Komisionit të Helsinkit në Hungari (shiko kontaktin në faqet 13, 15), në rast se ju nuk po e kuptoni se çfarë po ndodh në procedurën e Dublinit, ose në rast se keni frike që do ju çojnë në një shtet tjetër të Bashkimit Evropian.

B. KUSHTE TE TJERA QE DUHEN PËR PARAPRANIM

Mbasi Zyra e Emigracionit vendosi që Hungaria është shteti që duhet të merret me kërkesën tënde për azil, prapëseprapë ka dhe disa kushte të tjera që ju duhet ti plotësoni, që kërkesa juaj të shqyrtohet me detaje. Kërkesa juaj nuk do të pranohet në “procesin për merite” (shqyrtim i çështjes në detaje), dhe do të refuzohet në rast se:

- ti je një qytetar i një shteti të Bashkimit Evropian,
- të kane pranuar si azilant në një shtet tjetër e cila është pjesëtar e Bashkimit Evropian,
- të kane pranuar si azilant nga një shtet tjetër dhe, ky statut është akoma i vlefshëm dhe ti ke të drejte të kthehesh akoma në këtë shtet,
- Ti ke bërë njëherë me përpara kërkesën për azil në Hungari dhe nuk të është pranuar, dhe në rast se kërkesa jote e re përmban të njëjtat fakte si ajo e vjetra (dmthne nuk ka asnjë fakt të ri).

Te keni parasysh që në rast se ti bën një kërkesë të re për azil (mbasi e para të është refuzuar), ti duhet të paraqesësh fakte dhe rrethana të reja në lidhje me çështjen tënde, në krahasim me procedurën e pare.

Në rast se Zyra e Emigracionit vendos se kërkesa jote për azil është e “papranueshme”, që do të thotë që një nga pikat e mësipërme është e vlefshme për ty, ti ke të drejtën të apelosh kundër këtij vendimi negativ. Ti duhet ta paraqesësh apelimin tënd tek Zyra e Emigracionit brenda 3 ditëve. Në apelimin tënd duhet të shpjegosh se pse ti nuk je dakord me këtë vendim. Për shembull, në rast se ky nuk është aplikimi i pare për azil, duhet të shpjegosh se cilat janë faktet dhe rrethanat e reja (diçka që ka ndryshuar që nga hera e fundit që ju keni aplikuar për azil, ose keni fakte të reja konkrete, etj).

Kërkesa jote e apelit do të shqyrtohet nga **Gjykata e Kryeqytetit (Fővárosi Bíróság)** në Budapest:

- Gjykata do të vendos në bazë të dosjes që ka, dhe nuk do t’ju marr në intervistë. Në rast se dëshiron të shtosh ndonjë gjë mund të kërkoh një interviste me gjykatën, por gjykatësi mund të mos ta pranoje atë.
- Afati për gjykatën të marr ndonjë vendim është **8 dite** sipas ligjit. Kjo **zgjat më shumë në praktike** (1–2 muaj). Në rast se kërkon intervistë me Gjykatën, mund të zgjasë edhe më shumë.

Mund të kërkonti avokatin e Komisionit të Helsinkit në Hungari t’ju ndihmojë të shkruani apelin (shiko kontaktin në faqet 13, 15).

Procedura e paraprimit do të mbyllet në rast se ti mungon në një interviste ose në rast se ti zhdukesh!

? **Ku do qëndroj unë gjatë procedurës së paraprimit?**

Kjo varet se kur dhe ku aplikuat për azil:

- Në shumicën e rasteve do të qëndroni në kampin e refugjateve në Békéscsaba.
- Në rast se në kohën e aplikimit për azil ju ishit në “dënim” (burgu i te huajve në Győr, Kiskunhalas, Nyírbátor ose Aeroporti i Budapestit), ju do të qëndroni në burg gjatë procedurës së paraprimit. Në rast se ju ndodhni në aeroport dhe vendimi nuk është marrë brenda 8 ditëve atëherë do transferoheni në kampin e refugjateve në Békéscsaba.
- Në rast se ju jeni nën moshën 18 vjeç dhe nuk keni asnjë pjesëtar të familjes me vete, atëherë do ju dërgojnë në një strehim për minoritetet në Bicske. Në këtë strehë juve do ju jepet kujdesi i duhur.

? **A mund të dal nga kampi i refugjateve në Békéscsaba gjatë procedurës së paraprimit?**

Ky është një kamp i mbyllur, prandaj ju duhet të qëndroni atje gjatë procedurës. Sidoqoftë fëmijëve ju lejohet të shkojnë në shkollë, dhe në rast se keni nevojë të shkoni në spital, do ju çojnë atje. Kontaktoni drejtuesit e kampit ose punonjësit social të Shoqatës së Strehuarve në lidhje me këtë (kontaktoni në faqen 15).

? **Sa zgjat procedura e paraprimit në të vërtetë? Pse unë jam akoma në Békéscsaba, ndërkohe shokët e mi kanë dale me kohe?**

Varet nga shumë gjëra. Në disa raste ajo merr fund brenda 2 javëve. Në disa raste të tjera ajo zgjat deri në 3–6 muaj. Arsyet e një procedure të gjatë janë:

- Procedura e Dublinit, nga e cila varet procedura e paraprimit. Në rastin e shokëve tuaj nuk kanë pas procedure Dublini; prandaj ata janë liruar më herët nga Békéscsaba.
- Kërkesa jote nuk është pranuar, dhe ju keni bërë apelim gjykatës, e cila do kohë të vendosi. Vendimi i paraprimit i shokëve tuaj ka qenë pozitiv, ose negativ, por ata nuk kanë bërë apel.

? **Procedura ime e Dublinit po zgjat shume, kurse e tjerëve me pak. Pse ndodh kjo?**

Disa shtete të Bashkimit Evropian i përgjigjën shpejt kërkesës së Hungarisë, disa të tjera ngadalë. Për fat të keq as ju dhe as Zyra e Emigracionit nuk mund të ndikojnë tek kjo.

? **Unë kam bërë njëherë një kërkesë për azil në një shtet tjetër të BE-se dhe nuk mu pranua kërkesa. Perse autoritetet Hungareze duan akoma të me dërgojnë atje?**

Në rastin e procesit të Dublinit nuk ka rëndësi se ty nuk tu pranua kërkesa atje. Në rast se Zyra e Emigracionit vendos se ju keni bërë një kërkesë për azil njëherë në një vend tjetër të BE-se, procedura e Dublinit do të fillojë edhe pse ty tu refuzua kërkesa në atë vend. Te keni parasysh që përgjigjja nga një shtet tjetër i BE-se mund të zgjasë.

? **Çfarë të drejtash kam gjatë qëndrimit në Aeroport?**

Juve do ju japin ushqim 3 herë në dite (në bazë të besimit tënd) dhe në qoftë se keni lek/para mund të bleni ushqim më shumë në dyqanet e aeroportit. Mund të përdorni celularin tuaj. Ju mund të telefononi edhe nga telefonat publike në aeroport, pyesni një polic t’ju shoqërojë atje. Meqenëse ndodhni në aeroport për arsye sigurie nuk mund të dilni jashtë tij.

6. “Procedura për merite”

Mbas mbarimit pozitiv të procesit të parpranimit, ju do të kaloni në procesin “për merite” (*érdemi eljárás*). Në këtë pjesë të procesit Zyra e Emigracionit do të shqyrtojë faktin se ju e meritoni statutin e refugjatit, statutin e personit të mbrojtur apo statutin e toleruar (shiko në faqen 2).

Në këtë procedure, Zyra e Emigracionit do ju bëjë juve të paktën një **interviste** (por edhe me shumë). Në këto intervista do ju pyesin:

- Te dhënat e juaja personale,
- Si erdhe në Hungari, dhe
- Arsyet pse e le vendin tënd të lindjes.

Intervista e parë zakonisht behet pak javë mbas fillimit të këtij procesi. Ju duhet të kërkonti ndihmën e avokatit të Komisionit të Helsinkit në Hungari para intervistës së parë (shiko kontaktin në faqet 13, 15).

“Sinqeriteti” është shumë i rëndësishëm, në këtë proces, prandaj është e rëndësishme që gjatë intervistave ti tregosh në detaje pse le vendin e lindjes. Përpiqu të përqendrohesh në arsyet e vërteta pse ishit i detyruar te linit vendin dhe se kishit frikë. Përpiquni që mos të tregoni gjera kontradiktore.

Në rast se nuk mbani në mend një emër, vend ose date, mos u bëni merak dhe mos krijoni detaje jo të vërteta. Përpiquni ti tregoni nëpunësit sa më shumë informacione dhe ti shpjegoni atij pse nuk i mbani në mend të tjerat. Për shembull në rast se s’mbani mend një date të sakte përpiquni ta lidhni atë datë me ndonjë ngjarje të rëndësishme (“ishte fundi i një stine”, apo “ishin zgjedhjet”).

Ju duhet te dorëzoni pasaportën dhe dokumentet e identifikimit sa me shpejt në Zyrën e Emigracionit. në rast se ju nuk i dorëzoni ato kjo mund të ketë një ndikim negativ mbi çështjen tënde. Kuptohet, nuk është e detyrueshme që ju të paraqisni ndonjë dokument si dëshmi (certifikate, artikuj, fotografi, etj) për të mbështetur kërkesën tënde për azil. Por në rast se ju i keni këto me vete, atëherë këto mund t’ju ndihmojnë juve dhe paraqesin se ju po tregoni të vërtetën. Në rast se akoma nuk i keni dorëzuar këto dokumente jepjani punonjësit në intervistën e parë.

Një dokument i shkruar do të përgatitet gjatë intervistës së parë, në gjuhën Hungareze. Ky dokument do përmbajë të gjitha ato çfarë keni thënë ju gjatë intervistës. Në fund të intervistës atë do ua lexojnë dhe përkthejnë.

Të keni kujdes që ky dokument përmban saktësisht të gjitha ato çfarë keni thënë gjatë intervistës. Nëse mungon diçka ose është gabim, atëherë tregoni menjëherë nëpunësit, i cili do ta korrigjojë.

Në shumicën e rasteve është shumë e vështirë të tregosh arsyet, pse ti po kërkon azil. Por në rast se ju nuk tregoni problemet e tuaja të vërteta atëherë autoritetet do ta kenë shumë të vështirë të kuptojnë që ju keni nevojë për ndihme. Mund të kërkonti një pushim të shkurt, në rast se jeni i lodhur gjatë intervistës. Gjithashtu mund të kërkonti ndihmën e një psikologu nga Fondacioni Cordelia (shiko kontaktin në faqen 15) në rast se e keni të vështirë të flisni me nëpunësin për ngjarjen tënde të dhimbshme.

Te keni parasysh qe nëpunësi, përkthyesi, avokati juaj, punonjësi social dhe gjykatësi kane për detyrim ta mbajnë te fshehte çdo gjë qe ju thoni. Asgjë nuk do i tregohet autoriteteve te vendit tënd (as fakti qe ju kërkuat azil), në rast se kjo bën një rrezik për ty ose familjen tende.

Mbas intervistës tënde me nëpunësin e azilit, ka mundësi qe edhe Shërbimet e Sigurisë Kombëtare (Nemzetbiztonsági Hivatal) t'ju marrin në pyetje.

Afati i një procedure për shqyrtimin të detajshëm zgjat deri në 60 ditë, kjo mund të zgjatë edhe 30 ditë sipas ligjit. Zyra e Emigracionit zakonisht merr vendim **brenda 45 deri 90 ditë**.

Në fund të procesit për shqyrtim të hollësishtëm Zyra e Emigracionit mund të marri 5 vendime:

- Njohja e statutit të refugjatit (*menekült*).
- Njohja e statutit si person i mbrojtur (*oltalmazott*).
- Njohja e statutit qëndrim i toleruar (*befogadott*).
- Refuzim.
- Në rast se ju zhdukeni gjatë procedurës (në rast se nuk paraqiteni në intervista, Zyra e Emigracionit nuk mund të lidhet me ju, etj) procedura do mbyllet dhe do ndalohet.

Ju duhet të paraqiteni personalisht kur të shpallin vendimin. Një përkthyes do të përkthejë vendimin, dhe në rast se është negativ, do të shpjegojë se perse kanë marrë këtë vendim.

Ju mund të **apeloni** këtë vendim në rast se nuk jeni dakord me te. Ju duhet ta paraqisni apelimin tuaj **brenda 15 ditëve** në Zyrën e Emigracionit. në apelimin tuaj duhet të shkruani pse nuk jeni dakord me vendimin. Në këtë rast ju duhet të konsultoheni me avokatin e Komisionit të Helsinkit në Hungari (shiko kontaktin në faqet 13, 15).

Gjykata e Kryeqytetit (Fővárosi Bíróság) në Budapest do marri një vendim me apelimin tuaj. Afati për këtë është 60 ditë sipas ligjit, por në praktike procedura mund të zgjas **shumë muaj**. Gjykata është e detyruar t'ju **intervistojë** juve personalisht, në këtë rast ti ke mundësi t'ia shpjegosh historinë tënde gjykatësit. Kjo interviste ndodh disa muaj mbas apelimit. Është mirë të **konsultoni një avokat** në lidhje me këtë procedure.

Në fund të procesit Gjykata e Kryeqytetit mund të marri tre vendime:

- Te pranojë apelin tënd dhe t'ju njohe juve si refugjat, ose si person i mbrojtur, ose t'ju japë statutin qëndrim i toleruar.
- Pjesërisht të pranojë apelimin tënd dhe të anulojë vendimin e Zyrës së Emigracionit, dhe të urdhërojë Zyrën të fillojë një procedure të re për azil.
- Te refuzojë apelimin tuaj dhe të pranojë vendimin.

Vendimi i Gjykatës së Kryeqytetit është vendimtar dhe ju nuk mund të apeloni.

? Ku do qëndroj unë gjatë kësaj procedure (duke përfshirë dhe procedurën për parapranim)?

Ka mundësi të ndryshme:

- Në përgjithësi ju mund të qëndroni në kampin e refugjateve në Debrecen, ku do keni strehim dhe ushqim 3 here në ditë.

- Ju mund të zgjidhni edhe një strehim privat (për shembull në rast se keni ndonjë shok ose familjar i cili mund t'ju ndihmojë të gjeni një shtëpi me qira). Sidoqoftë, ju duhet të merrni leje nga Zyra e Emigracionit për të jetuar në strehim privat. Për të bërë këtë juve ju duhet certifikata e pronës (*tulajdoni lap*), e cila tregon se cili është pronari dhe kontratën e qirasë (*lakásbérleti szerződés*) ose një deklaratë me shkrim nga pronari që tregon se ai/ajo po të jep strehim (*befogadó nyilatkozat*).
- Në rast se ju jeni nën moshën 18 vjeç, dhe jeni në Hungari pa shoqëruar të rritur, atëherë ju do qëndroni në “kampin për minoritare të pashoqëruar” në Bicske. Në këtë kamp do kujdesen për juve me vëmendje.
- Disa azilantë të cilët aplikuan për azil gjatë kohës që ishin në burg, sepse kaluan kufirin dhe qëndruan në vend ilegalisht, ka mundësi që këta të qëndrojnë në burg, gjatë kohës së procedurës.

Të keni parasysh se në rast se ju vendosni të qëndroni në banesë private, adresa që ju jepni duhet të jetë e sakte për Zyrën e Emigracionit. Të bëni kujdes që emri është shkruar saktësisht si në derën e shtëpisë dhe në kutinë postale. Në rast se ju nuk i merrni letrat që Zyra e Emigracionit ju dërgon, ata do mendojnë se ju keni ikur, dhe ata do mbyllin procesin tuënd për azil.

? **A mund të dal nga kampi refugjateve në Debrecen gjatë procedurës për shqyrtim?**

Po, ky është një kamp i hapur, por në rast se ju dëshironi të largoheni për më shumë se 24 ore ju duhet të merrni leje nga drejtuesit e kampit. Në rast se ju e lini kampin për më shumë se një ditë atëherë, Zyra e Emigracionit do mendojë se ju keni ikur dhe do të mbyllin procedurën tuende për azil.

? **Si do të informohem unë për datën dhe vendin e intervistës?**

Një letër zyrtare do jua dorëzojnë juve me detajet e intervistës, në gjuhën Hungareze. Në rast se ju jeni në kampin e Debrecenit, punonjësi që merren me çështjen tuende do ju thotë juve të shkoni në zyrën e tij. Ku do ju informojë në lidhje me intervistën.

Në rast se ju rrini në shtëpi private, një postier do ua sjelli letrën nga Zyra e Emigracionit me informacionet e intervistës. Në rast se ju nuk ndodheni në shtëpi, atëherë do ju lejë një shënim në kutinë postale, dhe ju duhet të shkoni në postë për ta merrni letrën.

Në rast se ju keni një avokat, Zyra e Emigracionit do informojë edhe avokatin tuaj për datën dhe vendin e intervistës.

? **Zyra e Emigracionit e mbylli procesin tim për azil sepse ata kujtuan se unë kisha ikur. Ç'fare mund të bëj?**

Brenda 3 ditëve mbas mbylljes, ju mund të kërkonti autoritetet të vazhdojnë procedurën, kështu sa më shpejt të jetë e mundur bëne kërkesën.

? **Shërbimet e Sigurimit të Shtetit duan të më marrin në pyetje mua. A do të thotë kjo që ata mendojnë se unë jam terrorist?**

Jo. Ata kanë të drejtë të marrin në pyetje aplikantet për azil, dhe e bëjnë shpesh këtë gjë. Kjo nuk do të thotë se ato mendojnë që ju jeni një terrorist.

? **A kam të drejtë të punoj gjatë procedurës për shqyrtim?**

Ju mund të punoni vetëm në rast se ju qëndroni në një kamp refugjatesh, dhe vetëm brenda kampit mund të punoni. Për më shume informacione kontaktoni drejtuesit e kampit.

Sidoqoftë, në rast se procedura jote zgjat me shume se një vit, mbas një viti keni te drejte të punoni edhe jashtë kampit, por vetëm në rast se keni një leje pune. (*munkavállalási engedély*). Në këtë rast kontaktoni një punonjës social te Shoqatës se Emigranteve ose Zyrën e Emigracionit për ndihme (kontakto informacionin në faqen 15).

7. Statutat dhe te drejtat

Në fund të procedurës për shqyrtim të hollësishëm, në rast se aplikimi yt ishte i suksesshëm, Zyra e Emigracionit do të garantoje për t'ju mbrojtur në Hungari. Ekzistojnë 3 lloj statute mbrojtëse. Kur punonjësi do ju tregojë juve vendimin, ai/ajo do ju shpjegojë juve dhe statutin që keni përfutur.

3 statutat që ju mund ti përfitonit në procedurën për azil ju japin juve të drejta të ndryshme. Me poshtë është një përmbledhje e shkurtër e cila përmban shpjegime të rëndësishme të këtyre statuteve. Në rast se keni ndonjë pyetje kontaktoni një avokat të Komisionit të Helsinkit në Hungari ose një punonjës social të Shoqatës së Emigranteve.

8. Ku te shkoll për ndihme?

**Te gjitha shërbimet e mëposhtme janë falas dhe ju nuk duhet te paguani për ata!
Të gjitha organizatat e mëposhtme punojnë me përkthyes profesionale, dhe ju mund të komunikoni në gjuhën amtare ose në një gjuhë tjetër që e kuptoni mirë.**

Asistenca ligjore falas (në rast se keni nevojë për ndihmë në procedurën e aplikimit për azil) – **Komisioni i Helsinkit në Hungari** (*Magyar Helsinki Bizottság*)

- **Budapest (zyra qendrore)**
Adresa: 1054 Budapest, Bajcsy-Zsilinszky út 36–38.
Tel/fax: 06 1 321 4323, 06 1 321 4141
Adresa internet: www.helsinki.hu • E-mail: helsinki@helsinki.hu
Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht, Italisht Duhet të kërkonti takim!
- **Békéscsaba kampi i refugjateve / Dr. Tímea Kovács, avokat**
Tel: 06 20 496 7372
Gjuhët: Hungarisht, Anglisht. Vizitat në kampin Békéscsaba një herë në javë.
- **Debrecen kampi refugjateve / Dr. Orsolya Szántai-Vecsera, avokat**
Vendndoshja: C/5 "Integrációs Ház", në hyrje te kampit
Tel/fax: 06 52 448 446
Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Frëngjisht, Serbisht.
Konsultimet: Të Hënën dhe të Enjte pasdite, Të Premten në mëngjes.
- **Bicske Streha e minoritareve të pashoqëruar / Dr. Júlia Iván, avokat**
Adresa: Komisioni i Helsinkit në Hungari, 1054 Budapest, Bajcsy-Zsilinszky út 36–38.
Tel/fax: 06 1 321 4323
Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Frëngjisht. Vizitat në kamp në javët çift.
- **Budapest Aeroporti Nderkombetar, burgu i emigranteve ilegale / Dr. Gábor Győző, avokat**
Adresa: Komisioni i Helsinkit në Hungari, 1054 Budapest, Bajcsy-Zsilinszky út 36–38.
Tel/fax: 06 1 321 4323
Gjuhët: Hungarisht, Anglisht. Vizitat në aeroport në javët çift.

	Refugjati (menekült)	Person i mbrojtur (oltalmazott)	Qëndrim i toleruar (befogadott)
Për sa kohë është ky statut i vlefshëm?	Për kohe të papërcaktuara, por në disa raste autoritetet mund ta anullojnë këtë statut	Zakonisht për 5 vjet, por edhe mund ta anullojnë atë, ose rishikojnë. Ky statut duhet rinovuar.	Për 1 vit, por autoritetet mund ta rishikojnë dhe anullojnë edhe më herët. Ky statut mund të rinovohet mbas rishikimit.
A do marr një kartë identiteti Hungareze (személyi igazolvány)?	Po	Po	Jo, po do të merrni një kartë humanitare leje qëndrimi (<i>humanitárius tartózkodási engedély</i>)
A do marr pasaportë në rast se nuk kam?	Po (dokument udhëtimi për refugjatet)	Po	Jo
A kam të drejtë të punoj?	Po, pa ndalim, si qytetarë Hungareze		Po, por ju duhet një leje pune (<i>munkavállalási engedély</i>)
A mund të udhëtoj lirish në shtetet e tjera të Bashkimit Evropian?	Jo, në shumë raste të duhet vize. Për më shumë informacione kontakto ambasadën e shtetit ku dëshiron të udhëtosh.	Jo, në shumë raste të duhet vize. Për më shumë informacione kontakto ambasadën e shtetit ku dëshiron të udhëtosh.	Jo, vetëm në rast se keni pasaportë të vlefshëm, dhe do ju duhet një vize. Për më shumë informacione kontakto ambasadën e shtetit ku dëshiron të udhëtosh.
A mund të marr pjesëtarët e familjes në Hungari?	Po. Pjesëtarët e familjes: — Bashkëshorti/bashkëshortja, — fëmijët, nën moshën 18 vjeç, — prindërit (në rast se jeni fëmijë pa familje në Hungari), përndryshe vetëm prindërit ekonomikisht të varur nga ju (që s'mund të kujdesen për veten) — pjesëtar tjerë të familjes, që s'mund të kujdesen për veten, për shkak të gjendjes shëndetësore Ata duhet të kenë një dokument udhëtimi të vlefshëm. Në rast se ti e fillon bashkimin familjar 6 muaj mbas marrjes së statutit, ti NUK JE i detyruar të vërtetosh që je në gjendje të mbash familjen ekonomikisht dhe t'ju sigurosh atyre strehim në Hungari. Në rast se procedurën e fillon më vonë, atëherë duhet të plotësosh këto kushte. Për bashkim familjar pyet avokatit, ose punonjës social. Filli procedurën sa më parë.	Po. Pjesëtarët e familjes: — Bashkëshorti/bashkëshortja, — fëmijët, nën moshën 18 vjeç, — prindërit (në rast se jeni fëmijë pa familje në Hungari), përndryshe vetëm prindërit ekonomikisht të varur nga ju (që s'mund të kujdesen për veten) — pjesëtar tjerë të familjes, që s'mund të kujdesen për veten, për shkak të gjendjes shëndetësore Duhet të kenë një dokument të vlefshëm. Duhet të vërtetoni se jeni në gjendje të mbani familjen, tu jepni strehim dhe siguracion në Hungari. Për bashkim familjar pyete avokatit.	Po. Pjesëtarët e familjes: — Bashkëshorti/bashkëshortja, — fëmijët, nën moshën 18 vjeç, — prindërit (në rast se jeni fëmijë pa familje në Hungari), përndryshe vetëm prindërit ekonomikisht të varur nga ju (që s'mund të kujdesen për veten) — pjesëtar tjerë të familjes, që s'mund të kujdesen për veten, për shkak të gjendjes shëndetësore Duhet të kenë një dokument të vlefshëm. Duhet të vërtetoni se jeni në gjendje të mbani familjen, tu jepni strehim dhe siguracion në Hungari. Për bashkim familjar pyete avokatit.
A mund të marr nënshtrësi Hungareze?	Po, mbas 3 vjet qëndrimi të vazhdueshëm në Hungari mund të aplikosh për nënshtrësi, por duhet të plotësoni shumë kushte për ta marrë atë. Kur të vijë koha pyete avokatit.	Po, mbas 8 vjet qëndrimi të vazhdueshëm në Hungari, por duhet të plotësoni shumë kushte për ta marrë atë. Kur të vijë koha pyete avokatit.	Po, mbas 8 vjet qëndrimi të vazhdueshëm në Hungari, por duhet të plotësoni shumë kushte për ta marrë atë. Kur të vijë koha pyete avokatit.

➤ **Nyírbátor Burgu i emigranteve ilegale, strehe e përbashkët**

Dr. József Dobos, avokat

Adresa: 4400 Nyíregyháza, Ószőlő utca 108., III./10.

Tel: 06 70 774 8116

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Rusisht. Vizitat në burg çdo javë.

➤ **Győr Burgu i emigranteve ilegale / Dr. András Hajas, avokat**

Adresa: Böröcz Ügyvédi Iroda, 9021 Győr, Szent István utca 10.

Tel: 06 96 314 115

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Gjermanisht.

Vizitat në burg çdo javë.

Asistenca sociale falas (Në rast se ju duhet ndihme për të kërkuar një punë, një vend për të fjetur, keni probleme ose pyetje në lidhje me qëndrimin tënd në kampin e refugjateve, etj.) – **Shoqata e Emigranteve** (*Menedék Egyesület*)

➤ **Budapest (zyra qendrore)**

Adresa: 1090 Budapest, Erkel utca 13/A, katë perdhese 5.

Tel: 06 1 411 1710, 06 1 411 1711, 06 20 430 9919 • Fax: 06 1 411 1711

Adresa internet: www.menedek.hu • E-mail: menedek@menedek.hu

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Frëngjisht, Serbisht. Merrni në telefon për të lënë një takim!

➤ **Békéscsaba kampi refugjateve / Zsuzsa Perák, punonjës social**

Vendndodhja: Brenda kampit të refugjateve

Tel: 06 66 452 617

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Serbisht.

Konsultimet: Të Hënën dhe të Enjte paradite dhe pasdite, të premten paradite.

➤ **Debrecen kampi refugjateve / Éva Adóba, Anna Kerek, punonjësit social**

Vendndodhja: B/5 "Integrációs Ház", Në hyrje të kampit

Tel: 06 52 428 537, 06 70 331 9568 • Fax: 06 52 428 537

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Rusisht, Ukraine, Italisht.

Konsultimet: Të Hënën dhe të Enjte pasdite, dhe të premten paradite.

Asistenca psikologjike falas (Në rast se nuk ndiheni mirë, Në rast se nuk ju zë gjumi natën, në rast se ndiheni i mërzitur dhe ankoheni gjithë kohën, në rast se është e vështirë të flisni për çka ju ka ndodhur në vendin tuaj, në rast se keni ëndrra të këqija, etc.) – **Fondacioni Cordelia** (*Cordelia Alapítvány*)

➤ **Budapest (zyra qendrore)**

Adresa: 1133 Budapest, Kárpát utca I./B, kati 6, 24.

Tel: 06 1 349 1450 • Fax: 06 1 239 1332

Adresa internet: www.cordelia.hu • E-mail: cordelia@chello.hu

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Rusisht.

Në zyre nuk bëhen konsultime, por mund ti merrni në telefon për të lënë takim.

Psikiatrit e Fondacionit Cordelia bëjnë vizita në kampet e refugjateve në Békéscsaba,

Debrecen dhe Bicske një herë në javë (zakonisht të Enjteve).

Komisioni i Larte i Kombeve te Bashkuara për Refugjatet (UNHCR)

➤ **UNHCR Përfaqësuesit Rajonal për Evropën Qendrore**

Adresa: 1022 Budapest, Felvinci utca 27.

Tel: 06 1 3363 060 • Fax: 06 1 3363 080

Adresa internet: www.unhcr-budapest.org • E-mail: hunbu@unhcr.org

Asistenca për kthim vullnetar (në rast se keni dëshirë të ktheheni në atdhe) – **Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM)**

➤ **IOM Përfaqësuesit Rajonal për Evropën Qendrore dhe Jug-Lindore**

Adresa: 1065 Budapest, Révay utca 12.

Tel: 06 1 472 2500 • Fax: 06 1 374 0532

Adresa internet: www.iom.hu • E-mail: mrfbudapest@iom.int



© Komisioni i Helsinkit në Hungari • 2008

Formuar nga

Fondet Evropiane për Refugjatet, Komisioni i Larte i Kombeve te Bashkuara për Refugjatet

Shkruar nga

Gábor Gyulai